



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2096/<sub>2</sub> Prot

Rrëshen më, 10 . 06 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 49 datë 03. 06. 2024**

**PËR**

**“MIRATIMIN E KËRKESËS TË KOMPANISË “PLUS NETWORK” SHPK, ME OBJEKT: RINOVIM TË KONTRATËS NR. 4884 PROT, DATË 16. 06. 2022, LIDHUR ME BASHKINË MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 54, germa “e”, të ligjit nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, kreu i III-të nenit 15, ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar, VKM. nr.684 datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 433, datë 08. 06. 2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave/Bashkive” të ndryshuar, VKM. nr. 632, datë 12.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje bari”, VKM. nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM. nr. 559, datë 29.07.2022, Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të këkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, shkresës së admnistruar në bashki me nr. 1458 prot, datë 12.04.2024, me objekt: “Kërkesë për rinovim kontrate qiraje”, me nr. 4884 prot, datë 16.02.2022, projekt-vendimin së bashku me relacionin nr. 654 prot, datë 14.02.2024, e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e këshillit bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës së subjektit: “Plus Network” shpk, në ekonominë pyjore Domgjon, e admnistruar në bashki me nr. 1458 prot, datë 12.04.2024, me objekt: “Kërkesë për rinovim kontrate qiraje”, me nr. 4884 prot, datë 16.02.2022, e lidhur me bashkinë Mirditë.
2. Vlera e qirasë vjetore është **276 635** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë në vit.
3. Afati i dhënies me kontratë qiraje është 6 (gjashtë) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

4. Pjesë përbërse e këtij vendimi, bashkëlidhur relacioni nr. 2096 prot, datë 27.05.2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (agjencia e bujqësisë, ujitjes dhe administrimit pyjor dhe drejtoria juridike).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Aleksandër PICA KU**





**BASHKIA MIRDITË  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2036/Prot.  
12

Rrëshen, më 27 . 05 .2024

**P/VENDIM**

Nr. 59 datë 27/05 / 2024

**“ MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS TË KOMPANISË “ PLUS NETWORK ” SHPK,  
ME OBJEKT RINOVIM TË KONTRATËS NR. 4884 PROT., DATË 16.06.2022 ME  
BASHKINË MIRDITË**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, nenit 54/e, ligjin nr.57 datë datë 30.04.2020, “ Për pyjet ”, kreu i III-të nenit 15, ligjin nr.9693 datë 19.03.2007 “ Për fondin kullor ” të ndryshuar, VKM nr.684 datë 02.09.2020, “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive ” të ndryshuar, VKM-në nr. 632, datë 12.06.2009 “ Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje bari ”, VKM- nr.559, datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave ”, Udhëzimin nr.1.datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesws për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik ”, kërkes e subjektit “ PLUS NETWORK ” shpk, këshilli i bashkiak pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë:

**V E N D O S I:**

- 1-Miratimin e kërkesës së subjektit “ PLUS-NETWORK ” shpk, nw ekonomin pyjore Domgjon, e administruar në bashki me nr. 1458 prot, datë 12.04.2024, për rinovim të Kontratës me nr. 4884 prot., datë 16.06.2022.
- 2-Vlera e qirasë vjetore është 276 635 (dyqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e gjashtë qindë e tridhjetë e pesë ) lekë/vit.
- 3-Afati i dhënies me qira është 6 (gjashte) vjeçar me të drejtë rinovimi.
- 4-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë.

ADRESA: SHK. “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dh. fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.:

5-Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

**SEKRETAR**

**KRYETAR**

**Gasper TOPOLLAJ**

**Aleksander PICAKU**

Paraqiten Projektin.

Drejtori -ABUAPyjeve

Kastriot BICA

Drejtorja Juridike

Besian DEDAJ



**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**





## BASHKIA MIRDITË

Nr. 2086 Prot.

Rrëshen më 27.05.2024

### RELACION

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS TË KOMPANISË “ PLUS NETWORK ” SHPK,  
ME OBJEKT RINOVIM TË KONTRATËS NR. 4884 PROT., DATË 16.06.2022 ME  
BASHKINË MIRDITË**

*(Qiramarrës trualli dhe rrugë lidhëse, trase të linjës elektrike, për Vendosje të antenës së telefonisë celulare në fondin pyjor/kullosor, pasuri e bashkisë)*

Referuar aplikimit të kompanisë “ PLUS NETWORK ” shpk, bashkëngjitur shkresës së administruar në bashki me nr. 1458 prot, datë 12.04.2024, me objekt “ Kërkëse për rinovim kontrate qiraje ”; me nr. 4884 prot, datë 16.06.2022, e cila ka përfunduar me datë 15.06.2023, kërkon ta rinovojë këtë kontratë me të njëjtat kushte për një afat 6 (gjashtë) vjeçarë.

Grupi i punës i përbër nga; Përgjegjësjja e sektorit pyjor ing.Eneida Nikolli, specialistët ing. Gjovalin Nikolli dhe ing.Preng Nikolli, pasi shqyrtoi kërkesat e shoqërisë “ PLUS NETWORK ” shpk, realizoi verifikimin e dokumentacionit, dhe verifikimin në terren të sipërfaqes pyjore dhe kullosore ku ndodhet e instaluar antena e ish-kompanisë “ PLUS COMMUNICATION ”, në përfundim;

Duke qenë se kategoria e përdorimit dhe sipërfaqja që qiramarrësi ka në përdorim në fondin pyjor, prej 1.0059 ha, e gjendur në n/ngastrën nr. 48/a, Ekonomia Pyjore Domgjon, njësia administrative Fan, nuk ndryshon, si dhe tarifat për njësi, sipas VKM-së Nr. 559, datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ”, shtojca 1, pika 7, 11, nuk kanë ndryshuar, grupi i punës konkludon; Kontrata me nr. 4884 prot, datë 16.06.2022, nënshkruar me kompaninë, “ PLUS NETWORK ” shpk, të rinovohet me të njëjtat kushte, *(në këtë rast ndryshon vetëm tarifa për njësi, nga 8 500 000 lek/ha/vit, që ishte në 8 000 000 lek/ha/vit, për shkak të zgjatjes së afatit të përdorimit nga 1 vit në 6 vjet)*

-Tarifa totale për tu paguar për llogari të bashkisë Mirditë rezulton të jetë në shumën prej 276 635 (dyqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e gjashtë qindë e tridhjetë e pesë ) lekë/vit, e ndarë në;

-Tarifë trualli, 0.032 ha x 8 000 000 lekë/ha/vit = 256 000 lek/vit

-Tarifë rrugë lidhëse, 0.314 km x 50 000 lekë/km/vit = 15 700 lek/vit.

-Tarifë e trasesë së linjes elektrike, 0.141km x 35 000 lekë/km/vit = 4 935 lek/vit.

Ky relacion hartohet në 4 kopje dhe vihet në dispozicion të strukturave përgjegjëse të ngarkuara për hartimin ndjekjen e realizimn e këtyre kontratave në bashki.

**GRUPI I PUNËS**

Ing. Gjovalja Nikolli



Ing. Eneida Nikolli



Ing. Preng Nikolli



**DREJTORI**

Kastriot Bica



**KONFIRMOI**

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**

